









PJESA A: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë


1. Sa është vlera e $(20 + 18) : (20 - 18)$?				
(A) 18	(B) 19	(C) 20	(D) 34	(E) 36
2. Kur shkronjat e fjalës MAMA shënohen vertikalisht njëra nën tjetrën, fjala ka vijë vertikale të simetrisë.				
				
Cila nga fjalët e tjera kur të shënohet në të njëjtën mënyrë ka vijë vertikale të simetrisë?				
(A) ROOT	(B) BOOM	(C) BOOT	(D) LOOT	(E) TOOT
3. Një trekëndësh ka gjatësitë e brinjëve 6, 10 dhe 11. Një trekëndësh barabrinjës ka të njëjtin perimetër. Sa është gjatësia e brinjës së trekëndëshit barabrinjës?				
(A) 6	(B) 9	(C) 10	(D) 11	(E) 27
4. Cili numër duhet të zëvendësojë * në ekuacionin vijues që ekuacioni të jetë i saktë $2 \cdot 18 \cdot 14 = 6 \cdot * \cdot 7$?				
(A) 8	(B) 9	(C) 10	(D) 12	(E) 15
5. Panelet e rrethojës së Agimit janë plot me vrima. Një mëngjes, njëra nga panelet ra në tokë. Cilën nga figurat mund të sheh Agimi gjersa i afrohet rrethojës së tij?				
				
A)	(B)	(C)	(D)	(E)
				

6. Bleroni po grumbullon shkallët që janë 15 cm të gjata dhe 15 cm të thella, siç tregohet në figurë. Sa shkallë i nevojiten atij për të arritur te kati i dytë i ndërtesës që është 3 metra mbi katin e parë?




(A) 8	(B) 10	(C) 15	(D) 20	(E) 25
-------	--------	--------	--------	--------

7. Një lojë përbëhet nga hedhja e një topi nga maja e një kutie që ngushtohet siç tregohet në figurë. Topi kthehet në të djathtë ose në të majtë çdo herë që godet një pengesë të rrumbullakët. Një rrugë e mundshme e lëvizjes së topit është treguar më poshtë. Sa rrugë të ndryshme mund të bëjë topi për të arritur në shportën B?




(A) 2	(B) 3	(C) 4	(D) 5	(E) 6
-------	-------	-------	-------	-------

8. Një drejtkëndësh i madh përbëhet nga nëntë drejtkëndësha identik brinja më e gjatë e të cilëve është 10 cm. Sa është perimetri i drejtkëndëshit të madh?




- | | | | | |
|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| (A) 40 cm | (B) 48 cm | (C) 76 cm | (D) 81 cm | (E) 90 cm |
|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|

9. Diagrami tregon drejtkëndëshin me dimensione 7×11 që përmban dy rrrathë ku secili prej tyre i takon tri brinjë të drejtkëndëshit. Sa është distanca në mes të qendrave të rrrathëve?




- | | | | | |
|-------|-------|-------|-------|-------|
| (A) 1 | (B) 2 | (C) 3 | (D) 4 | (E) 5 |
|-------|-------|-------|-------|-------|

10. Katrori $ABCD$ ka brinjët me gjatësi 3 cm. Pikat M dhe N gjenden në AD dhe AB ashtu që CM dhe CN e ndajnë katrorin në tri pjesë më sipërfaqe të njëjtë. Sa është gjatësia e DM ?



- | | | | | |
|------------|----------|------------|----------|------------|
| (A) 0.5 cm | (B) 1 cm | (C) 1.5 cm | (D) 2 cm | (E) 2.5 cm |
|------------|----------|------------|----------|------------|


<p>16. Dua dëshiron të shënojë një listë të numrave të thjeshtë më të vegjël se 100, duke përdorur secilën nga shifrat 1,2,3,4 dhe 5 saktësisht një herë dhe asnjë shifër tjetër. Cili numër i thjeshtë do të jetë në listën e saj, pavarësisht se si ajo e formon listën?</p>													
(A) 2	(B) 5	(C) 31	(D) 41	(E) 53									
<p>17. Një hotel në një ishull në Karaibe bën shpalljen: "çdo vit 350 ditë me diell!". Duke u bazuar në shpalljen, atëherë sa është numri më i vogël i ditëve që Besarti duhet të kalojë në hotel në vitin 2018 që të sigurohet që të ketë dy ditë të njëpasnjëshme me diell?</p>													
(A) 17	(B) 21	(C) 31	(D) 32	(E) 35									
<p>18. Diagrami vijues tregon drejtkëndëshin dhe drejtëzën X paralele me bazën. Dy pikat A dhe B gjenden në drejtëzën X në brendi të drejtkëndëshit. Shuma e sipërfaqeve të trekëndëshave të hijezuar është 10 cm^2. Sa është sipërfaqja e drejtkëndëshit?</p>													
													
(A) 18 cm^2	(B) 20 cm^2	(C) 22 cm^2	(D) 24 cm^2	(E) varet nga pozita e pikave A dhe B									
<p>19. Jona shënoi numra të plotë të ndryshëm, nga 1 deri në 9 në secilën nga qelulat e tabelës 3×3. Ajo njehsoi shumën e numrave të plotë në secilin rresht dhe në secilën kolonë të tabelës. 5 nga përgjigjet e saj janë 12, 13, 15, 16 dhe 17, në ndonjë renditje.</p>													
<table border="1" style="border-collapse: collapse; width: 100px; height: 100px;"> <tr><td style="width: 33px; height: 33px;"></td><td style="width: 33px; height: 33px;"></td><td style="width: 33px; height: 33px;"></td></tr> <tr><td style="width: 33px; height: 33px;"></td><td style="width: 33px; height: 33px;"></td><td style="width: 33px; height: 33px;"></td></tr> <tr><td style="width: 33px; height: 33px;"></td><td style="width: 33px; height: 33px;"></td><td style="width: 33px; height: 33px;"></td></tr> </table>													
Sa është përgjigja e gjashtë?													
(A) 17	(B) 16	(C) 15	(D) 14	(E) 13									
<p>20. Njëmbëdhjetë pika janë shënuar nga e majta në të djathtë në një vijë të drejtë. Shuma e të gjitha distancave mes pikës së parë dhe pikave të tjera është 2018. Shuma e distancave mes pikës së dytë dhe pikave të tjera përfshirë edhe pikën e parë është 2000. Sa është distance mes pikës së parë dhe pikës së dytë?</p>													
(A) 1	(B) 2	(C) 3	(D) 4	(E) 5									

PJESA C: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë

21. Për një pozitë si monitorues janë 3 kandidatë dhe 130 studentë votues. Naimi ka deri tash 24 vota, gjersa Samiu ka 29 dhe Shpëtimi ka 37. Sa vota më shumë i nevojiten Shpëtimit për t'u përzgjedhur?

- | | | | | |
|--------|--------|--------|--------|--------|
| (A) 13 | (B) 14 | (C) 15 | (D) 16 | (E) 17 |
|--------|--------|--------|--------|--------|

22. Diagrami tregon rrjetën e një kutie drejtkëndëshe të shpalosur.



Sa është vëllimi i kutisë?

- | | | | | |
|-----------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------|-------------------------|
| (A) 43 cm^3 | (B) 70 cm^3 | (C) 80 cm^3 | (D) 100 cm^3 | (E) 1820 cm^3 |
|-----------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------|-------------------------|


23. Riga dëshiron të shënojë nga një numër në secilën qelulë në kufi të tabelës 5×6 . Në secilën qelulë, numri që ajo shënon është baraz me shumën e dy numrave në qelulat me të cilat kjo qelulë ka të përbashkët një brinjë. Dy nga numrat janë shënuar në diagram.

10						3
	X					

Cilin numër do të shënojë ajo në qelulën ku gjendet x ?

- | | | | | |
|--------|-------|--------|-----------|----------|
| (A) 10 | (B) 7 | (C) 13 | (D) -13 | (E) -3 |
|--------|-------|--------|-----------|----------|


24. Fisniku dhe Nderimi vendosën të bëjnë një garë. Fisniku vrapon përgjatë perimetrit të bazenit që tregohet në diagram, gjersa Nderimi noton në gjatësinë e bazenit. Fisniku vrapon tre herë më shpejt se sa që Nderimi noton. Nderimi notoi gjashtë gjatësi të bazenit gjersa Fisniku u soll pesë herë përreth bazenit. Sa është i gjerë bazeni?



- | | | | | |
|----------|----------|----------|----------|-----------|
| (A) 25 m | (B) 40 m | (C) 50 m | (D) 80 m | (E) 180 m |
|----------|----------|----------|----------|-----------|


25. Klubi fluturues i Lavdimi dizajnoi një flamur të një pëllumbi f në një rrjetë katrore siç tregohet në figurë. Sipërfaqja e pëllumbit është 192 cm^2 .

Të gjitha pjesët e perimetrit të pëllumbit ose janë pjesë të ndonjë rrethi ose janë vija të drejta. Sa janë dimensionet e flamurit?




- | | | | | |
|-----------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| (A) 6 cm x 4 cm | (B) 12 cm x 8 cm | (C) 20 cm x 12 cm | (D) 24 cm x 16 cm | (E) 30 cm x 20 cm |
|-----------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|

26. Themi se pllakat e dominos janë vendosur në mënyrë korrekte nëse numri i pikave në fundet e dy dominove fqinje është i njëjtë. Pleurati vendosi 6 domino siç tregohet në diagram Ai mund të bëjë lëvizje ose duke ndërruar pozitat e cilado dy domino ose duke e rrotulluar një domino. Sa është numri më i vogël i lëvizjeve që duhet të bëjë për të vënë të gjitha pllakat në mënyrë korrekte?



- | | | | | |
|-------|-------|-------|-------|------------------------------|
| (A) 1 | (B) 2 | (C) 3 | (D) 4 | (E) Ëshë e pamundur të bëhet |
|-------|-------|-------|-------|------------------------------|

27. Pikat N, M dhe L gjenden në brinjët e trekëndëshit barabrinjës ABC, ashtu që $NM \perp BC$, $ML \perp AB$ dhe $LN \perp AC$, siç tregohet në figurë. Sipërfaqja e trekëndëshit ABC është 36. Sa është sipërfaqja e trekëndëshit LMN?



(A) 9 (B) 12 (C) 15 (D) 16 (E) 18


28. Lindita, Mimoza dhe Rrezja shkuan të bëjnë blerje. Mimoza shpenzoi vetëm 15 % të asaj që shpenzoi Rrezja. Lindita shpenzoi 60 % më shumë se Rrezja. Së bashku shpenzuan 55 EUR. Sa shpenzoi Lindita?

(A) 3 (B) 20 (C) 25 (D) 26 (E) 32

29. Viola po praktikon kërcimin e gjatë. Distanca mesatare që ajo kërcëu sot është 3.80 m. Në kërcimin e saj të radhës ajo kërcëu 3.99 m dhe mesatarja e saj u rrit në 3.81 m. Cilën distancë duhet të kërcëjë ajo në kërcimin tjetër ashtu që mesatarja të rritet në 3.82 m?

(A) 3.97 m (B) 4.00 m (C) 4.01 m (D) 4.03 m (E) 4.04 m

30. Në trekëndëshin barakrahësh ABC pikat K dhe L janë shënjuar në brinjët AB dhe BC përkatësisht ashtu që $AK = KL = LB$ dhe $KB = AC$. Sa është madhësia e këndit ABC?



(A) 30° (B) 35° (C) 36° (D) 40° (E) 44°

Çara Math Kangaroo - Kosovë
Klasat 7-8

